



EUROPEAN UNION

## Njësia Qendrore e Rregullatorit Zyra e Rregullatorit për Energji



United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

### Udhëzim i Përkohëshëm No. 02/2004 Mbi Kushtet dhe Procedurat për Kyçje të Reja në Rrjetin e Distribucionit të Ngrohjes Qëndrore

#### **KAPITULLI 1 Dispozitat e Përgjithshme**

##### **Neni 1**

Në përputhje me UNMIK/REG/2000/49 Mbi Themelimin e Departamentit Administrativ të Shërbimeve Komunale Publike, Njësia Qendrore e Rregullatorit/Zyra e Rregullatorit për Energji lëshojnë këtë Udhëzim për Kushtet dhe Procedurat për Kyçje të Reja në Rrjetin e Distribucionit të Ngrohjes Qëndrore (“Udhëzimi”)

##### **Neni 2 Qëllimi**

- 2.1 Ky udhëzim përcakton kushtet dhe procedurat për kyçjet e reja në rrjetin e distribucionit të ngrohjes qëndrore në perjudhën e përkohëshme deri sa të zbatohet Ligji për Ngrohje Qëndrore dhe legjislacioni përkatës sekondar.
- 2.2 Ky është një Udhëzim i përkohëshëm dhe do të jetë valid deri sa të zëvendësohet nga Rregulli për Kushtet e Përgjithshme për Furnizim të Energjisë
- 2.3 Termet e përdorura në këtë Udhëzim do të kenë të njejtin kuptim ashtu si e kanë në Ligjin e Rregullatorit për Energji Nr. 2004/9, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/20, e dates 30 Qershor, 2004.

##### **Neni 3 Definimi**

- 3.1 Kyçja e re përbëhet nga kyçja e rrjetit të distribuimit të ngrohjes me paisjet e konsumatorit. Fillon në degën e rrjetit të distribuimit dhe përfundon tek pika furnizuese përveç në rast se bëhet ndonjë marrveshje tjetër.
- 3.2 Kyçja deri të pika furnizuese i takon ndërmarrjeve operuese të ngrohjes dhe është pronë e këtyre ndërmarrjeve.

## **KAPITULLI 2      Procedura e Kycjes së Konsumatorëve të Rinjë në Rrjetin e NQ-së**

### **Neni 4    Fillimi i Procedurës**

- 4.1 Çdo konsumatorë i vendosur në zonën e shërbimit që mbulohet nga ndërmarrja e ngrohjes qendrore, do të ketë të drejtë, atëher kur është e mundëshme teknikisht dhe ekonomikisht, që të kyç objektet e tij të ngrohjes dhe paisjet në rrjetin e NQ-së, nëse ky konsumatorë i plotëson kushtet në vazhdim:
- (a) Ka në pronësi ose ka përgjegjësi të plotë që të operoj sistemin sekondar intern që dërgon ngrohjen tek shfrytëzuesit e fundit, duke plotësuar kërkesat për siguri teknike dhe operative;
  - (b) Plotëson kushtet për kyçje në rrjetin e distribucionit; dhe
  - (c) Ka nënshkruar një kontratë me shkrim me furnizuesin për kyçje.
- 4.2 Çdo konsumatorë i mundëshëm duke qenë pronar ligjor i ndërtesës që duhet të kyçet në rrjetin e ngrohjes qendrore mund të aplikoj në ndërmarrjen e ngrohjes për Kushtet e Kyçjes.
- 4.3 Konsumatorët nuk do të kenë të drejt për tu kyçur nëse kushtet e kyçjes nuk janë plotësuar ose nëse kyçja do të qonte në çrregullime të mëdha në furnizim ose do të shfaqen shpenzime të larta disproporcionale për furnizuesin.
- 4.4 Një ndërmarrje e ngrohjes mund të refuzoj përkohësisht që të kyç një konsumatorë në sistemin e ngrohjes nëse përcaktohet që objektet, paisjet ose rrjeti i distribuimit dështon në plotësimin e standardeve teknike ose kushteve të tjera. Konsumatori duhet të informohet me shkrim për arsyen e ndonjë refuzimi të tillë.

### **Neni 5    Aplikimi për Kushtet e Kyçjes**

- 5.1 Një formular i Aplikacionit për Kushtet e Kyçjes do të lëshohet nga ndërmarrja e ngrohjes.
- 5.2 Një aplikacion për Kushtet e Kyçjes duhet të specifikoj:
- a) Emrin e Aplikuesit;
  - b) Llojin dhe parametrat e sistemit sekondar të konsumatorit;
  - c) Kapacitetin e ngrohjes që do të kontraktohet;
  - d) Informata për kërkesën vjetore të ngrohjes për metër katror të sipërfaqës së ngrohur dhe karakteristikat teknike të ndërtesës (vëllimin dhe sipërfaqën e dhomave të ngrohura, sistemin e ventilimit, humbjet e llogaritura të ngrohjes);
  - 5) Fillimin e dërgimit të ngrohjes të propozuar nga konsumatori.
- 5.3 Aplikuesi duhet të dorztoj tek ndërmarrja e ngrohjes në formë të dokumentit të bashkangjitur dokumentet në vazhdim:

- a) Deklarimin e pronësisë ose të drejtën ligjore për të përdorur ndërtesën që do të kyçet në rrjetin e NQ-së;
- b) Planin e situacionit që tregon lokacionin e ndërtesës që do të kyçet në rrjetin ekzistues të NQ-së dhe instalimet e tjera nëntokësore.

## **Neni 6 Kushtet e Kyçjeve**

6.1 Kushtet e Kyçjeve të lëshuara nga ndërmarrjet e ngrohjes duhet të definojnë:

- a) Vendin dhe mënyrën se si nën-stacioni do të kyçet në rrjetin e gypave të furnizimit;
- b) Limitimin në pronësi të instalimit brenda dhomës së nënstacionit;
- c) Dizajnimin e rrjedhjes së bartësit të ngrohjes dhe tabelave rregulluese;
- d) Kërkesat në lidhje me:
  - Planin (“layout-in) e nënstacionit;
  - Lokacioni për valvulën e kontrolluese për të rregulluar rrjedhjen e bartësit të ngrohjes dhe lokacionin për matësin e ngrohjes;
  - Lokacioni për njehsorin e ujit shtesë që furnizon sistemin sekondar.
- e) Informatat e tjera të nevojshme për dizajnimin e nënstacionit dhe sistemit sekondar;
- f) Validiteti i Kushteve të Kyçjes.

6.2 Ndërmarrja e ngrohjes do të lëshoj kushtet për kyçje brenda 30 ditëve që nga data e marrjes së aplikacionit të definuar në Nenin 5. Një draft kontratë për kyçje duhet ti bashkohet.

6.3 Kushtet e Kyçjes do të jenë valide dy vjet pasi që kushtet të jenë lëshuar.

## **Neni 7 Kontrata e Kyçjes**

7.1 Kontrata e Kyçjes, e përpiluar në mes ndërmarrjes së ngrohjes dhe konsumatorit, do të definoj:

- a) Palët që lidhin kontratën;
- b) Mënyrën e kryerjes së punëve të projektimit, ndërtimit, testimit dhe vënjes në punë (komisionimit) nga secila pale kontraktuese;
- c) Mënyra e koordinimit të punëve të kryera nga palët dhe kontrolli i kërkesave të definuara në kushtet e kyçjes;
- d) Afatet kohore për përfundimin e punëve ndërtimore për kyçje, të nën-stacionit dhe sistemit sekondar si dhe për testim dhe vënjën në punë (komisionimin);
- e) Mënyra e financimit të kyçjes së re, nënstacionit dhe sistemit sekondar dhe mënyrën e kalkulimit të shpenzimeve përkatëse;
- f) Data e pritur për fillim të dërgimit të ngrohjes;
- g) Përgjegjësia e të dy palëve në rast se kushtet e kontratës nuk përmbushen;
- h) Përgjegjësia për mirëmbajtje dhe riparim të nënstacionit dhe sistemit sekondar;
- i) Obligimin e konsumatorit që të vë në dispozicion pa pagesë, një dhomë ose lokacion të përshtatshëm për të instaluar paisjet e nënstacionit;
- j) Obligimin e konsumatorit që të mundësoj qasje në nënstacion për lexim dhe inspektim të paisjeve matëse.

### **KAPITULLI 3 Fillimi i Punëve**

#### **Neni 8 Kushtet e Përgjithëshme**

- 8.1 Kontrata e Kyçjes është bazë dhe obligim për të filluar dizajnimin (projektimin) dhe punët ndërtimore përkatëse brenda dy muajve pasi që kontrata të jetë nënshkruar.
- 8.2 Testimi dhe vënja në punë (komisionimi) i kyçjeve të reja, nënstationit dhe sistemit sekondar do të bëhen në prezencën e përfaqësuesve nga të dy palët.
- 8.3 Në rastin kur punët e kyçjes janë kryer para sezonës së ngrohjes, testet e nevojshme dhe komisionimi përfundimtar mund të bëhen gjatë sezonës së ngrohjes në kohën e dakorduar nga të dy palët, pas fillimit të dërgimit të ngrohjes tek konsumator i ri i kyçur.
- 8.4 Rezultatet e testeve dhe vënjes në punë (komisionimit) duhet të konfirmohen me protokol të nënshkruar nga të dy palët. Forma e protokolit lëshohet nga ndërmarrja e ngrohjes.

#### **Neni 9 Obligimet e Konsumatorit**

- 9.1 Konsumatori është i obliguar që ti mundësoj qasje pa pagesë personave të autorizuar për të kryer punët ndërtimore brenda ndërtesës së tijë.
- 9.2 Konsumatori do ti ofroj qasje pa pagesë në dhomat ose lokacionet e veta ku ndonjë paisje e nënstationit do të instalohet dhe do të mbuloj shpenzimet që janë të ndërlidhura me mirëmbajtjen.

#### **Neni 10 Obligimet e Ndërmarrjes së Ngrohjes**

- 10.1 Ndërmarrja e ngrohjes është e obliguar që të njoftoj konsumatorin për kohën e punëve të parapara në një afat të mjaftueshëm për përgaditje të objektit të konsumatorit. Dispozita e njoftimit duhet të definohet në kontratën e kyçjes;
- 10.2 Ndërmarrja e ngrohjes ose përfaqësuesit e saj do të kyçin paisjet e konsumatorit në rrjetin e distribucionit të ngrohjes dhe ta vendosin atë në sistem.

### **KAPITULLI 4 Tarifa e Kyçjes**

#### **Neni 11 Kostoja e Kyçjes**

- 11.1 Shpenzimet që janë bazë për kalkulim të kostos së kyçjes së re përmbajnë:
  - a. Shpenzimet e dizajnit (projektimit) dhe punëve inxhinjerie për kyçje
  - b. Blerja e materialit
  - c. Gropimi i kanalit të kyçjes në mes rrjetit egzistues dhe pikës së kyçjes
  - d. Puna e instalimit dhe kyçja e linjes së re të gypave

- e. Shpenzimet e mbushjes së kanalit duke përfshirë rehabilitimin e sipërfaqës në gjendjen e mëparshme.
- f. Shpenzimi për kyçje të paisjeve të konsumatorëve në rrjetin e distribucionit dhe vendosja në shërbim
- g. Testimi dhe vënja në punë (komisionimi) i kyçjes së re
- h. Shpenzimet financiare.

11.2 Ndërmarrjet e ngrohjes janë të obliguara që të ofrojnë shpenzime të kyçjes të arsyeshme dhe efikase; është në diskrecionin e Zyres së Rregullatorit të Energjisë që të bëjë krahasimin (“benchmarking”) e ndërmarrjeve të ngrohjes në lidhje me shpenzimet e kyçjes.

### Neni 12 Kalkulimi i Kostos Njësi të Kyçjes

12.1 Kosoja njësi për kyçje do të kalkulohet për çdo madhësi (diametër) të gypave bazuar në formulën:

$$U_{con_i} = K_{con_i} : L_{con_i}$$

ku:

<b>U<sub>con<sub>i</sub></sub></b>	Kostoja njësi e kyçjes me gypa të diametrit “i”	€/ m
<b>K<sub>con<sub>i</sub></sub></b>	Totali i kostos (shpenzimeve) vjetore për kyçje të reja të bëra duke përdorur gypat me diametër “i”	€/ vit
<b>L<sub>con<sub>i</sub></sub></b>	Gjatësia totale vjetore e kyçjeve të reja të bëra duke përdorur gypa të diametrit “i”	m / vit

### Neni 13 Kalkulimi i Totalit të Kostos së Kyçjes

13.1 Totali i kostos i secilës kyçje individuale do të kalkulohet sipas formulës:

$$P_{con} = U_{con} \times I_{con}$$

ku:

<b>P<sub>con</sub></b>	Totali i kostos (shpenzimeve) i kyçjes së re	€
<b>U<sub>con</sub></b>	Kostoja njësi e kyçjes për diametrin e definuar të gypave	€/ m
<b>I<sub>con</sub></b>	Gjatësia e linjës së gypave për kyçjen e re	m

### Neni 14 Tarifa e Kyçjes që Paguhet nga Konsumatori

14.1 Tarifa e kyçjes është pjesëmarrja e konsumatorit në totalin e kostos për kyçje të re.

Do të kalkulohet sipas formulës:

$$F_{con} = k_p \times P_{con}$$

ku:

<b>F<sub>con</sub></b>	Tarifa e Kyçjes që paguhet nga konsumatori	€
<b>k<sub>p</sub></b>	Koficienti i pjesëmarrjes së konsumatorit në totalin e kostos të kyçjes së re	--
<b>P<sub>con</sub></b>	Totali i kostos për kyçje të re	€

- 14.2 Koficiti i pjesëmarrjes së konsumatorit **k<sub>p</sub>** duhet të jetë në diapazonin (kufijt) prej 0.3 - 0.6; është në lirin e veprimit të ndërmarrjes së ngrohjes që të vendos në vlerën ekzakte të **k<sub>p</sub>** brenda diapazonit (kufijve), varsisht nga kushtet lokale të kyçjeve për secilin rast individual.

## KAPITULLI 5 Dispozita Përfundimtare

### Neni 15 Shqyrtimet

- 15.1 Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të mbaj shqyrtime të rregullta, për qëllim të evaluimit të informative vjetore financiare të vlerësuara dhe të raportuara nga ndërmarrjet e ngrohjes qëndrore.

### Neni 16 Gjuha dhe Hyrja në Fuqi

- 16.1. Aplikacionet dhe dokumentet e bashkangjitura të përcaktuara me këtë Udhëzim duhet të kompletohen në një të njërit nga gjuhët zyrtare në Kosovë. Aplikuesi duhet të përkthej dokumentet që nuk janë në gjuhën shqipe, serbishte, ose anglishte.
- 16.2. Ky Udhëzim do të jetë i aplikueshëm menjëher pasi të jetë nëshkruar.

**Drejtori i Njësisë Qendrore të Rregullatorit**

---

Bjorn Hauksson

Data: 27 Shtator, 2004

